



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), nenin 65.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 28.3.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ. FLORENTINA KUKAJ** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës - PDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Shqipe Zogu.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Glllogoc, që ky vendim t'i komunikohet znj. Florentina Kukaj, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 13.03.2019, Nr.156/2019, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit znj. Shqipe Zogu, pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye të marrjes së pozitës së Drejtoreshës për Rini Kulture dhe Sport në Glllogoc.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatës së radhës sipas listës së rirenditur, e cila është, znj. Florentina Kukaj, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 28.03.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka